



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 688/1 prot.,

Tiranë, më 20.03.2025

VENDIM

Nr. 13, datë 20.03.2025

PËR

**“MIRATIMIN E PËRFITIMIT TË BURSËS STUDENTORE DHE PËRJASHTIMIT
NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTES ME NOTË
MESATARE 9-10, SARA PATAJ, E CILA STUDION NË NJË PROGRAM STUDIMI
TË CIKLIT TË INTEGRUAR NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr.329/11 prot., datë 19.03.2025 “Kërkesë për miratim të përfitimit të bursës studentore dhe përjashtimit nga tarifa e shkollimit për studentin e Fakultetit të Mjekësisë, Sara Pataj”,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës studentore dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit të studentes me notë mesatare 9-10, Sara Pataj, e cila studion në një program studimi të ciklit të integruar në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë
2. Efekti financiar për bursën e shkollimit është 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë dhe për përjashtimin nga tarifa e shkollimit është 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë. Ky efekt mbulohet nga fondet grant të buxhetit të shtetit për vitin 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ

MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI